

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SOPIKU FRUIT" SHPK**

**KREU I
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMRI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte **"SOPIKU FRUIT"** SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**NENI 2
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Zona Kadastrale 3196 me numer pasurie 355/47 , ndertese 1 kateshe rruga Fier-Berar Roskovec Fier, Shqiperi.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose mbi transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi. brenda apo jashte Republikes se Shqiperise .

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivite tin e saj per nje periudhe kohore me afat te pacaktuar.

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

- 4.1 Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar. brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise. duke u fokusuar kryesisht ne:
- a) Tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshem;
 - b) Import - eksport i mallrave industriale, ushqimore ;
 - c) Transport mallrash;
 - d) Prodhim, grumbullim, perpunim fruta perime
 - e) Prodhim fidanesh
- 4.2 Per permbushjen e objektit te saj Shoqeria:
- a) Mund te marre pjese dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe sipermartje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivite te njejta. te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesemarrese;
 - b) Mund te lidhe kontrata shitblerje, perdorimi, shkembimi. sipermartje apo

- a) marreveshje te tjera me investitore, bashke investitore, pronare trualli apo objektesh;
 - b) Mund te kryeje te gjithë veprimet e nevojshme ose te dobishme ose qe kane te bejne, perfshire por pa u kufizuar ne: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale per detyrimet e veta dhe se te treteve, veprime me pasuri te luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjeter qe ka te beje me objektin e saj ose qe mundeson nje perdorim me te mire te strukturave dhe/ose burimeve nepermjet shoqerive ose sipermarrjeve ne te cilat, direkt apo indirekt, Shoqeria ka pjesemarrje apo kontrollin e tyre.
- 4.2 Shoqeria mund te veproje ne Shqiperi dhe jashte saj dhe te kryeje do aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes me qellim te permbushe ose te jete i dobishem per permbushjen e objektit te saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 (Njeqindmije) Leke, i ndare ne 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqerise nenshkruset menjehere dhe do te paguhet nga ortakët qe zoterojne 100 % (njqind per qind) te kontributeve ne kapitalin e shoqerise, perkatesisht:
- 1. **Z. Fatmir Sopiku**, shtetas shqiptar , i lindur ne Roskovec Fier, me 26.09.1970, identifikuar me leternjoftimin me nr. 036097913 dhe numer personal H00926024D, i cili zoteron 50.00% (pesedhete, presje zero perqind) te kapitalit;
 - 2. **Z. Ervin Sopiku**, shtetas shqiptar, i lindur ne Roskovec Fier, me 09.07.1974, identifikuar me leternjoftimin me nr. 036097935 dhe numer personal H40709013Q, i cili zoteron 50.00% (pesedhete, presje zero perqind) te kapitalit;
- 5.2 Ne rast zmadhimi apo zvogelimi te kapitalit themeltar te Shoqerise, ortakët do te kene te drejten e nenshkrimit te zmadhimit apo zvogelimit te kapitalit ne perpjesetim te drejte me pjesemarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

- 6.1 Ne rast se nje ortak apo nje bashkezoterues i nje kuote humb jeten, trashegimtaret e tij do te jene te vetmet persona qe do ti njihet titulli mbi kuoten nga Shoqeria; por asnje nga keto parashikime nuk cliron pergjegjesite e trashegimtareve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zoteruara Ne rastine vazhdimit te Shoqerise me disa trashegimtare te ortakut qe ka humbur jeten, trashegimtaret duhet te caktojne nje perfaqesues te perbashket.
- 6.2 Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortakut mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter te caktuar prej tij si perfitues i

kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti te vlefshem te transferimit te kuotes.

- 6.3 Personi qe fiton te drejttat mbi nje kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te nje ortakut do te kete te drejttat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejttat e pjesemarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve qe jane thirrur por nuk ishin te pranishem ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe vendosi per zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortakët do te kene te drejttat te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne perpjesetim te drejte me kuotat qe zoterojne ne Shoqeri.
- 7.3 Ne rast se disa ortakë heqin dore nga e drejta e nenshkrimit te pjeses se tyre. kapitali i panenshkruar mund te nenshkruhet nga ortakët e tjere . Ne kete rast, keta ortakë mund te ushtrojne serish te drejttat per nenshkrimin e kapitalit, ne perpjesetim te drejte me kuotat e pjesemarrjes ne Shoqeri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne cdo rast, kapitali i Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e percaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e perballojne zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, ne perpjesetim te drejte me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise.

KREU III ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 9 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi te gjitha eshtjet per te cilat eshte kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti

- dhe/ose do marreveshje midis ortakeve te Shoqerise.
- 9.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne perputhje me pjeset e kapitalit qe ai zoteron ne Shoqeri.
 - 9.3 Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër ose nga nje perfaqesues i deleguar me prokure me shkrim.
 - 9.4 Ortaku nuk mund te delegoje te drejten e votes per nje pjese te kuotave te tij te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesen e mbetur.
 - 9.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te mbahet brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*) audio ose video, ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dote quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nenshkruhet procesverbali perkates.
 - 9.6 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise. Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te behet nepermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresate njoftuara Shoqerise, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e saj. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes.
 - 9.7 Asambleja e Pergjithshme do te mblidhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitete, ne rast se te gjithë ortaket apo perfaqesuesit e tyre jane te pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.
 - 9.8 Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme kryesohen nga Administratori/et. Asambleja e Pergjithshme cakton nje sekretar per do mbledhje midis personave te pranishem.
 - 9.9 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.
 - 9.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
 - 9.11 Asambleja e Pergjithshme, ne rastin e vendimeve qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose perfaqesuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë perqind) te kapitalit te Shoqerise, pervec rasteve te parashikuara me poshte ne nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Pergjithshme thirret ne nje mbledhje te dyte brenda 30 (tridhjetë) diteve nga mbledhja e pare.
 - 9.12 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres apo te perfaqesuar qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

KREU IV
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 10
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqeria administrohet nga nje apo me shume Administratore te cilet zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh. Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme.
- 10.2 Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, pervese atyre qe ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organeve te tjera te Shoqerise.
- 10.3 Administratori vepron ne perputhje me politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e Shoqerise. Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur pergjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per administrimin e Shoqerise.
- 10.4 Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shoqerise. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dh e do te heqe dore nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.
- 10.5 Administratori i pare i Shoqerise dote jete:
- Z. Ervin Sopiku, shtetas shqiptar, i lindur ne Roskovec Fier, me 09.07.1974, identifikuar me leternjoftimin me nr. 036097935 dhe numer personal H40709013Q

NENI 11
SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

- 11.1 Asambleja e Pergjithshme percakton shperblimin e Administratorit te Shoqerise.

NENI 12
PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

- 12.1 Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:
- (a) i perfundon mandati;
 - (b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
 - (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
 - (d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
 - (e) mungon pa arsye ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj



radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENTI

NENI 13 KONTROLLI FINANCIAR

- 13.1 Kontrolli financiar i Shoqerise kryhet ne perputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme do te emeruje nje apo me shume Eksperte Kontabel te Autorizuar ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 14 VITI FINANCIAR

- 14.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

NENI 15 BILANCI VJETOR

- 15.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.
- 15.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 16 DIVIDENTI

- 16.1 Pasi te jene permbushur kerkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese te Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 16.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithe dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen

sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate do pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.

KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 17
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

17.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 18
LIGJI I ZBATUESHEM

18.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.


NENI 19
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

19.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, dote zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.


Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKET

Fatmir SOPIKU

Fatmir Sopiku


Ervin SOPIKU

Ervin Sopiku


DATE: 09.04.2021